

Paralajmërim mbi riskun e investimit në instrumentin “Kontratë për Diferencë” (CFD)

CFD, si instrument financiar, përfaqëson një marrëveshje midis blerësit dhe shitësit për të shkëmbyer diferencën midis çmimit aktual të një letre me vlerë dhe çmimit të tij në momentin e lidhjes së kontratës.

Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) vazhdimisht ka paralajmëruar investitorët për rrezikshmërinë që paraqet oferta e disa produkteve spekulative siç janë kontratat për diferencë (CFD), si dhe opsionet binare. Këto produkte nuk janë të përshtatshme për të gjithë investitorët. Për këtë arsye tërheqim vëmendjen: Mos investoni, nëse nuk kuptoni karakteristikat e këtyre produkteve! Përpara se të merrni vendimin për tregtimin e këtyre produkteve lexoni me kujdes kontratën me ofruesin e CFD-ve, si dhe kërkoni këshillim profesional për të konstatuar se cilat produkte janë të përshtatshme për Ju.

Përhapja e këtyre produkteve ngre shqetësim, përse i përket mbrojtjes së investitorit, pasi këto produkte janë me shumë risk, komplekse dhe spekulative. Mbikëqyrësit kanë konstatuar se këto produkte shpesh shiten nëpërmjet një marketingu agresiv dhe që disa kompani nuk veprojnë në përputhje me Direktivën Evropiane për Instrumente Financiare, MIFID, duke shkaktuar kështu humbje të papritura për investitorin. Këto produkte nuk janë të standardizuara dhe karakteristikat e produktit mund të ndryshojnë nga njëri ofrues tek tjetri. Në shumicën e rasteve ka rezultuar që klientët që kanë investuar në CFD, opsione binare dhe produkte të tjera me karakter spekulativ i kanë humbur paratë e tyre. Këto lloj produktesh janë ofruar kryesisht në tregjet evropiane nëpërmjet platformave *online*. Fitimet potenciale reklamohen nga këto platforma në një mënyrë të tillë që të nxisin investitorin që të tregtojë, pa shpjeguar riskun e humbjeve të mundshme, kështu që investitori mund të arrijë në konkluzionin e gabuar që këto produkte kanë pak apo aspak risk. Ofruesit e këtyre produkteve për të joshur investitorët mund të ofrojnë tutoriale/udhëzime, skonto, komisione më të ulëta në mënyrë që ata të fillojnë tregtimin në këto platforma. Për më tepër, duhet theksuar që këto produkte ofrohen edhe nga kompani të parregulluara dhe të palicencuara, fakt ky që e shton më shumë rrezikun e investimit në këto produkte. Zakonisht investimi në këto produkte, sidomos kur ato ofrohen *online* nuk shoqërohet me këshillim në investim, çfarë do të thotë që nuk merret në konsideratë përshtatshmëria e klientit për të investuar në këto lloj produktesh. Nëse një kompani që ofron këto produkte është e licencuar, ajo duhet së pari të kontrollojë nëse klienti është i përshtatshëm për të investuar në këto produkte spekulative dhe nëse është i vetëdijshëm për riskun që ai merr përsipër.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në funksion të mbrojtjes së investitorit i bën thirrje investitorëve shqiptarë që përpara se të investojnë në këto lloj produktesh të kontrollojnë më parë nëse ofruesit e këtyre produkteve janë të autorizuar dhe licencuar për të ofruar këto shërbime nga rregullatorët e vendeve përkatëse.

Nëse një kompani ju kontakton për të investuar në instrumenta financiare *online*, atëherë ju lutem të siguroheni më parë nëse kjo kompani është e licencuar. Për këtë mund të konsultoheni me faqen zyrtare të Autoritetit në rubrikën *Regjistri i të Licencuarve* apo të kontaktoni direkt Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Ndërkohë, Ju këshillojmë të kontrolloni herë pas here rubrikën “Kini Kujdes” në faqen zyrtare të AMF-së.

Gjithashtu, mund t’i referoheni faqes zyrtare të ESMA-s <http://www.esma.europa.eu>, në të cilën është publikuar lista dhe *website* i të gjitha Autoriteteve Rregullatore të Vendeve të Bashkimit Evropian dhe ku mund të gjeni paralajmërimet mbi rrezikshmërinë e instrumentave financiare si CFD, apo *binary option*.